



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN DHE ME JASHTË

Tiranë, më 23.04.2026

N J O F T I M – V E N D I M Z H V I L L U E S

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në datën 22.01.2026, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative me nr. nr. **35008-00150-00-2025** akti që u përket palëve: Ankues: Agjencia e Trajtimit të Pronës, Person i tretë: A. S., përmbarues gjyqësor, Objekti: Kundërshtimi i veprimeve përmbarimore në lidhje me “Ekzekutimin e detyrueshëm”, me nr. 1673-2019 regj., datë 23.05.2019 për vënien në ekzekutim të vendimit nr. 48, datë 05.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit. Pezullimin e veprimeve përmbarimore, për ekzekutimin e vendimit nr. 48, datë 05.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Për shkak të specifikave që paraqet rasti në gjykim, në mbështetje të nenit 62 (1) (c) të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, Kolegji ka vlerësuar se është e nevojshme dëgjimi i palëve në seancë gjyqësore, me qëllim zhvillimin e praktikës gjyqësore, duke shtruar pyetjen:

- Cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e padisë për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, kur këto të fundit janë kryer, në bazë të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, që ka gjykuar si shkallë e parë mosmarrëveshjet administrative, të lindura me shkak ligjor, ligjin nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar?

Pas zhvillimit të seancës gjyqësore të datës 23.04.2026, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në arsyetimin e mësipërm referuar pyetjes së shtruar për zhvillim vlerëson se, duhet të arrihet në përcaktimin e rregullit zhvillues:

- Gjykata kompetente për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, kur këto të fundit janë kryer, në bazë të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, që ka gjykuar si shkallë e parë mosmarrëveshjet administrative, të lindura për shkak të ligjit nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar, është Gjykata Administrative e Apelit.

Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 1 pg.2, në lidhje me nenin 58, nenin 62/a pika 2 dhe neni 63, pika 1, shkronja “ç” të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendosi:

1. Prishjen e vendimit nr. 1950 (86-2024-2117) datë 14.11.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të vendimit nr. 1971, datë 06.06.2019 të Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë dhe kthimin i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit me tjetër trup gjykues.

2. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.